



# BULETINI METROLOGJIK

NR.1- 2024



REPUBLIKA E SHqipëRIË  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT

**dpm**  
|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|

Drejtoria Përgjithshme e Metrologjisë

---

# PËRMBAJTJA

## Pasqyra e lëndës:

1. Vizioni dhe Misioni.....	3
2. Mbledhja e Parë e Këshillit të Metrologjisë.....	4
3. Vizitat vlerësuese të ekspertëve të EURAMET-it në DPM.....	5
4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, pjesë e Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP) Albania.....	6-8
5. Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.....	8-11
6. Promovim i aktiviteteve të DPM-së.....	11
7. Lista e subjekteve të autorizuara dhe të revokuara për kryerjen e shërbimeve në metrologjinë ligjore.....	12





## **1.Vizioni**

Zhvillimi i infrastrukturës bazë metrologjike në zonat prioritare për ekonominë dhe inovacionin në industri për të ruajtur aftësinë dhe për të siguruar gjurmueshmërinë metrologjike të matjeve. Plotësimi i kërkesave të Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (CIPM MRA) për të garantuar gjurmueshmërinë dhe njohjen zyrtare të matjeve të proceseve të prodhimit në nivelin më të lartë të cilësisë si mekanizëm për të hequr barrierat teknike në tregti për prodhuesit dhe eksportuesit vendas.



## **Misioni**

Rregullimi i sistemit të njësisë së matjes, standardeve të matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimin e sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.



## 2. MBLEDHJA E PARË E KËSHILLIT TË METROLOGJISË

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 10, të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë” dhe VKM nr.152, datë 11.03.2022 “Për përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë”, më datë 08.02.2024, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), u zhvillua mbledhja e Këshillit të Metrologjisë.

Mbledhja e Këshillit të Metrologjisë u hap me një prezantim mbi aktivitetin, organizimin, dhe funksionimin e DPM-së, si dhe arritjet e vitit 2023 dhe objektivat e vitit 2024.

Z. Petrit Rama, Drejtor i Përgjithshëm i DPM-së, në fjalën hapëse e cilësoi takimin si prezantim të aktiviteteve të DPM-së për anëtarët si dhe vuri në dukje rëndësinë e veçantë të mbledhjes së këtij Këshilli.

Më në detaje çështjet e trajtuara dhe të diskutuara nga anëtarët përfshinë rolin e DPM-së, rëndësinë e saj, përbërjen e metrologjisë, krijimin dhe organizimin e saj, bazën ligjore mbi të cilën funksionon (ligji, VKM-të, Urdhërat dhe Udhëzimet e Ministrit). Anëtarët u prezantuan me aktivitetet e Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI), Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve (DSCP), si dhe organizimin e tyre, ndërtimin e Sistemit Kombëtar të Metrologjisë, anëtarësimin ndërkombëtar të DPM-së, shërbimet kalibruese (labororët kalibrues të masës, volumeve, presionit, gjatësisë, elektrikut, temperaturës dhe lagështirës, tre prej të cilave ju njihen certifikatat ndërkombëtarisht, pasi kanë deklaruar aftësitë matëse dhe kalibruese).



Për pjesën e arritjeve të vitit 2023, u veçuan realizimi i shërbimeve të verifikimit të 40000 instrumenteve matëse dhe kalibrimit të 2352 instrumenteve matëse, prezantimi në Bruksel për transpozimin e 5 (pesë) direktivave të BE për fushën e metrologjisë, në kuadër të procesit “Screening”, për Kapitullin I “Lëvizja e Lirë e Mallrave”, rishikimi i manualeve të cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17025:2017, për labororët kalibrues, përgatitja e procedurave për standardin ISO/IEC 17020:2012, për akreditimin në fushën e masës, si laborator inspektues. Një element tjetër ishte edhe diskutimi për draft Strategjinë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut, 2023–2030, e cila do përfshijë në një hark kohor 10 vjecar rishikimin e akteve nënligjore, lidhur me përafrimin e legjislacionit me BE, aktualisht me përputhshmëri gati 90%, hapjen e fushave të reja në laboratore, njohjen ndërkombëtare të shërbimeve metrologjike (nëpërmjet akreditimit, ose vetëdeklarimit të aftësive matëse dhe kalibruese).



Në pjesën e objektivave të vitit 2024, DPM ka prioritet mbrojtjen e konsumatorit nga matjet e pasakta, prezantimin e rezultateve të vlerësimit (peer review) të ekspertëve të EURAMET-it, në fushën e masës, volumeve, presionit dhe menaxhimit të cilësisë. Njohjen ndërkombëtare arritja për laboratorët e matjeve elektrike, lagështirës, temperaturës dhe gjatësisë dhe akreditimi sipas standartit ISO/IEC 17020:2012, në fushën e masës për metrologjinë ligjore si trup inspektuese.

### 3. VIZITAT VLERËSUESE TË EKSPERTËVE TË EURAMET-IT NË DPM

Në kuadër të njërit prej objektivave të DPM-së për kalimin me sukses të vlerësimit (peer review) të Sistemit të Menaxhimit për përmbushjen e kërkesave të ISO IEC 17025:2017 dhe të CIPM MRA u realizua në ambientet e DPM-së në datë 22-23 Janar dhe 6-8 Shkurt, vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të DPM-së nga;

- Z. Dyonisios Kyriakidis, vlerësues i SM nga Instituti grek i Metrologjisë (EIM);
- Z. Andrea Malengo, vlerësues teknik i laboreve të masës dhe volumeve të Institutit të Metrologjisë Italiane (INRIM);
- Z. Yasin Durgut, vlerësues teknik i laboratorit të presionit nga Instituti Turk i Metrologjisë (UME) Turqi.



Ky vlerësim është regjistruar në EURAMET me projektin Nr. 1605 dhe bëhet në kuadër të ri-vlerësimit çdo 5 vjet nga ana e EURAMET-it në përputhje me rregullat dhe standartet e organizatës për 3 fushat që kanë të deklaruar aftësitë matëse kalibruese (CMC) në BIPM KCDB, përkatesisht për laboratorin e masës, volumeve dhe presionit. Nga ky rishikim u konkludua se Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë ka krijuar një sistem të Menaxhimit të Cilësisë që është në përputhje me kërkesat e ISO 17025:2017 dhe në vazhdim do të zbatojë veprimet korrigjuese për secilin moskonformitet të zbuluar.



#### 4. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË, PJESË E PROGRAMIT GLOBAL PËR CILËSI DHE STANDARDE (GQSP) ALBANIA.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë është pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania me fokus "Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta - perimet" e cila implementohet nga UNIDO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial dhe Sekretariati Zviceran Shtetëror për Punët Ekonomike (SECO).

Në kuadër të këtij projekti, edhe gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2023 janë zhvilluar disa aktivitete dhe mbledhje, ndër të cilat përmendim:

##### a) Forumi i Parë Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet, Nëntor 2023



Forum i parë Kombëtar për Cilësi dhe Standarde 2023 u organizua nga UNIDO, në kuadër të Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Tiranë. Ky forum kombëtar synoi të rrisë ndërgjegjësimin për nevojën e krijimit të një kulture për cilësi për prodhuesit, institucionet dhe konsumatorët final, duke krijuar kështu një platformë ku të dëgjohen të gjithë zërat.

Forum i shërbeu për të krijuar një komunikim konstruktiv midis prodhuesve, sipërmarrësve, institucioneve dhe ekspertëve. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë si pjesë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë ishte pjesëmarrëse në këtë forum ku theksoi rëndësinë e mbështetjes së industrisë nëpërmjet digjitalizimit.

Më shumë informacion mund të gjeni në [https://issuu.com/unidoalbania/docs/post-forum\\_publication\\_final\\_cover\\_with\\_albania](https://issuu.com/unidoalbania/docs/post-forum_publication_final_cover_with_albania).



b) Aktivitet ndërgjegjësues në Reç, Malësi e Madhe



Ekipi i UNIDO Albania së bashku me institucionet shqiptare të infrastrukturës së cilësisë u mbledh në Reç, Malësin e Madhe në datë 25 Tetor. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të DPA, DPS, DPM, ATTC Shkodër, fermerë dhe anëtarë të kooperativës REÇ.

Gjatë këtij takimi fermerët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) dhe aktorët kryesorë diskutuan mbi sfidat e sektorit duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën për cilësi dhe standarde në zinxhirin e vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta perimet.

Kjo është një përpjekje kolektive, për të promovuar dhe priorizuar cilësinë në bujqësi. Duke rritur njohuritë në fushën e cilësisë, ne synojmë një konsumator të sigurtë dhe një eksport të shtuar të bimëve medicinale.




c) Bashkëpunim me Institutin Zviceran të Metrologjisë, METAS

- Vizitë në DPM nga përfaqësues të Institutit Zviceran të Metrologjisë (METAS) vizitë në DPM

Në datën 12 Tetor, stafi i DPM-së mori pjesë në seminarin e organizuar nga UNIDO, GQSP Albania dhe ekspertë të METAS në ambientet e DPM-së në lidhje me tre fusha të rëndësishme si parapaketimet, akreditimi i shërbimeve dhe analizat kimike në fushën e pesticideve.

Pjesëmarrësit shkëmbyen ide me ekspertët e METAS-it në fushën e metrologjisë dhe fituan njohuri të vlefshme për këto aspekte. Vështrimet dhe udhëzimet e ekspertëve do të ndihmojnë DPM-në të përmirësojë më tej praktikat e metrologjisë dhe të sigurojë standarde më të larta të saktësisë. Gjatë qëndrimit në DPM, ata zhvilluan dhe një vizitë në laboratorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.





- Vizitë në METAS nga përfaqësues të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) .

Zvicra është e njohur për standardet e larta të cilësisë dhe për matje të sakta dhe institucioni kyç që e garanton këtë është Instituti Zviceran i Metrologjisë, METAS. Kjo është arsyeja pse një ekip nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë realizoi këtë vizitë studimore dhe punoi me kolegët e METAS.

Gjatë vizitës u diskutua për metodologjitë e reja në planin ligjor, menaxhimin e cilësisë dhe analizat laboratorike. Përvoja 3-ditore ka qenë shumë e dobishme për DPM-në pasi u shkëmbyen mendime për rritjen e cilësisë dhe standardeve të produkteve shqiptare. Krijimi i një udhërrëfyese strategjik për Shqipërinë do të forcojë kapacitetet teknike për të garantuar menaxhim cilësor veçanërisht për eksportuesit shqiptarë të bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe fruta -perimet.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë, falenderon Institutin Zviceran të Metrologjisë (METAS) dhe në veçanti Z. Andres Hanspeter dhe Znj. Gisela Umbricht për bashkëpunimin e vazhdueshëm në këtë fushë.



## 5. PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2023 në kuadër të përmbushjes së njërit prej objektivave të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), përkatësisht të rritjes të kapaciteteve menaxhuese e profesionale të administratës, punonjësit e DPM-së kanë siguruar pjesëmarrjen në disa aktivitete ndërkombëtare ndër të cilat përmendim:

a) Takimin e 58-të të Komitetit Ndërkombëtar të Metrologjisë Ligjore, CIML.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë vitit 2023 siguroi pjesëmarrjen në Takimin e 58-të të Komitetit Ndërkombëtar të Metrologjisë Ligjore (CIML) në Chiang Mai, Tajlandë, në datat 17 - 19 Tetor. Pjesëmarrës në takim ishin përfaqësues nga 54 shtete, pesë organizata anëtare dhe një organizatë bashkëpunëtoare. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua në këtë takim nga Znj. Marsela Hasi, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore. Gjatë takimit, presidenti i CIML, Dr. Roman Schwartz, raportoi mbi aktivitetet kryesore dhe ndryshimet e anëtarësimit që kishin ndodhur gjatë vitit 2023. Si rezultat i përpjekjeve dhe burimeve të rëndësishme, të vendosura për të menaxhuar borxhin e anëtarëve, këtë vit asnjë shtet anëtar i







çështje të lidhura me krahasimet ndërlaboratorike, guidat e kalibrimit, projektet e EMPIR, propozimet për bashkëpunime dhe kërkime shkencore.

Me interes të veçantë nga përfaqësuesit e DPM-së u ndoqën sesionet për strategjinë në fushën e masës të këtij komiteti të fokusuar në aspektin teknik dhe digjitalizimin nëpërmjet implementimit të certifikatës digjitale të kalibrimit. Gjatë sesioneve u diskutuan shembuj praktik të certifikatës digjitale të kalibrimit të dhënësit të forcës dhe gramarit.



OIML-së nuk u përjashtua. Gjithashtu, nga komiteti u rinovuan mandatet e disa përfaqësuesve të tij, u prezantua dhe miratua situata financiare për vitin 2024 dhe u theksua dhe u theksua fakti që organizata vazhdon të jetë në një pozitë të mirë financiare, edhe pse ekzistojnë ende vonesa të pagesave të kuotizacioneve. Organizatat bashkëpunëtoare, ku përfshihen BIPM, CECIP, IAF, ILAC, dorëzuan raportet me shkrim mbi aktivitetet e tyre. BIMP bëri një raport mbi ecurinë e punës teknike të organizatës, si dhe nga komiteti u miratuan listat e projekteve dhe publikimeve me prioritet.

### b) Komiteti teknik i Masës i EURAMET-it

Komiteti Teknik i Masës dhe Njësive që rrjedhin prej saj u zhvillua në datat 18-21 Shtator 2023, në Bruksel, Belgjike, ku Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua nga Znj. Alma Jarani, Përgjegjëse e Sektorit të Masës dhe Densitetit dhe Z. Henkel Cico, Specialist i Sektorit të Matjeve Mekanike. Gjatë takimit, pjesëmarrësit të grupuar në grupe pune, diskutuan



### c) Komiteti teknik i Gjatësisë i EURAMET-it

Komiteti Teknik i Gjatësisë u zhvillua në Espoo, Finlandë, në datë 9-10 Tetor 2023, ku Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua nga Z. Dëfrim Bulku, Përgjegjës i Sektorit të Matjeve Dimensionale. Pjesëmarrja në këtë takim, ishte një prioritet i sektorit, pasi laboratorit i gjatësisë ka siguruar pjesëmarrjen në projektin e ndërkrahasimit EURAMET.L-S2.2.n01 për blloqe fundore, me të cilin synon deklarimin e CMC-ve në fushën e gjatësisë. Ky laborator siguron gjurmueshmërinë e njëjësive të matjes, është mbajtës i etaloneve dhe realizon shërbime kalibrimi për nevoja të industrisë.



### d) Pjesëmarrje në takimin e 33-të të Grupit të Punës 6 (WP 6) “Bashkëpunimi rregullator dhe politikat standardizuese”

Takimi i 33-të i Grupit të Punës 6 (WP 6) “Bashkëpunimi rregullator dhe politikat standardizuese” organizuar nga sekretariati i



UNECE u zhvillua në Gjenevë, Zvicër, në datat 23-24 Nëntor 2023. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, u përfaqësua në këtë takim nga Znj. Romina Çukaj, Specialiste në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore.

Çështjet që u trajtuan në këtë takim kishin të bënin me standardizimin dhe teknikat rregullatore, mbikëqyrjen e tregut, menaxhimin e riskut në sistemet rregullatore, sigurimin metrologjik të vlerësimit të konformitetit dhe testimin, edukimin mbi standardizimin etj. Të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE), Organe të Kombeve të Bashkuara,



Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (ITC), Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore (OIML), etj. Gjatë takimit pati diskutime të frytshme mbi adresimin e përputhshmërisë së vazhdueshme - vlerësimin e konformitetit, metrologjinë ligjore dhe mjetet e mbikëqyrjes të tregut në kushtet e dinamikës së ndryshimit të mallrave digjitale.

## 6. PROMOVIM I AKTIVITETEVE TË DPM-SË

- Vizitë e studentëve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në laboratorët e DPM-së

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë mirëpriti në 16 Janar 2024 në ambientet e laboratorëve të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, studentët e vitit të tretë të Inxhinierisë Mekanike nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Në këtë vizitë studentët patën rastin të bashkëbisedojnë me stafin e laboratorëve të DPM-së duke u njohur kështu me nga afër instrumentet matëse dhe procesin e punës që zhvillohet në këto laboratore.

DPM falënderon pedagogen Prof. Mirela Koçi dhe studentët e saj për pjesëmarrjen në këtë takim dhe është gjithmonë mikëpritëse për vizita, bashkëpunime dhe promovime të aktiviteteve të saj.



- Ndërgjegjësim mbi infrastrukturën e cilësisë, në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Fushata kombëtare mbi rolin dhe rëndësinë e metrologjisë në infrastrukturën e cilësisë u zhvillua në qytetin e Shkodrës në datë 24 Tetor.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS) zhvilluan një takim me studentë të universitetit, "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Përfaqësues të DPM-së prezantuan para studentëve dhe pedagogëve aspekte të përgjithshme të metrologjisë, shërbimet e verifikimit dhe kalibrimit si edhe rëndësinë e metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorit. Pjesëmarrësve iu shpërndanë materiale të shumta edukuese dhe ndërgjegjësuese mbi rolin dhe rëndësinë e metrologjisë në jetën e përditshme.





## **7. LISTA E SUBJEKTEVE TË AUTORIZUARA DHE TË REVOKUARA PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE NË METROLOGJINË LIGJORE.**

a) “NDP” SHPK, me nr. NIPT-i: K32408006C, me adresë Njësia Administrative Nr.7, Rruga “Skënder Shtylla”, Ndërtesa Nr.8, Kodi Postar 1023, Tiranë, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr. 8, datë 10.10.2023 “Për Riparim, Verifikim dhe Vulosje të përkohshme të Instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, Shpërndarës Karburanti”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 10.10.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 09.10.2027;

b) “M&M Topuzi Group” SHPK, me nr. NIPT-i: L03306201H, me adresë Metalurgji, Elbasan, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.09, datë 27.10.2023 “Për një ndryshim në Vendimin Administrativ Nr. 3, datë 10.07.2023”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 27.10.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 18.07.2027;

c) “Metro-Alb 12” SHPK, me nr. NIPT-i: L24211001V, me adresë lagjja 17, Rruga “Marigo Pozio”, Korçë, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.11, datë 15.12.2023 “Për një ndryshim në vendimin administrativ nr.2, datë 28.02.2022, “Për dhënien e autorizimit për verifikim të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara matësa uji”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 15.12.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 28.02.2026;

d) “Enea Nuhu” Person Fizik, me nr. NIPT-i: M11316007A, me adresë rruga “7 Nëntori”, Fushë-Mëzez, Kashar, Tiranë, revokuar sipas Vendimit Administrativ Nr.7, datë 13.09.2023

“Për shfuqëzimin e Autorizimit “Vendim Administrativ Nr.3, datë 06.05.2022 për kryerjen e Riparimit, Verifikim dhe Vulosje të përkohshme të Instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, Shpërndarës Karburanti”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 13.09.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 12.09.2026;

e) “FERALB” SHPK, me nr. NIPT-i: K04005025F, me adresë Lagjja nr.1, rruga “Telemak Germenji”, Korçë, revokuar sipas Vendimit administrativ Nr.10, datë 27.10.2023 “Për shfuqëzimin e Autorizimit “Vendim Administrativ Nr.5, datë 03.10.2022, për kryerjen e Riparimit, Verifikim dhe Vulosje të përkohshme të Instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, Shpërndarës Karburanti”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 27.10.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 26.10.2026.

**KËSHILLI BOTUES**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT



Drejtoria Pergjithshme e Metrologjise



## Kontakt:



[metrology@dpm.gov.al](mailto:metrology@dpm.gov.al)



<https://www.dpm.gov.al/>



<https://www.facebook.com/dpmGovAL/>

---

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë, Shqipëri